



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2198/5 prot.

Datë 26.10.2022

V E N D I M

Nr. 1047/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.10.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me Nr. REF-41744-09-14-2022, me objekt: “*Studim projektim për rikonstruksionin e rrugës Adria nga rotonda e Urës së Dajlanit deri tek rotonda pranë Stacionit të Trenit*” me fond limit 2.988.992 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK.
Lagjja 3, Rruga Egnatia dhe Rruga Ramazan Jella, Pallati 1125, Kati i parë, Durrës

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës
Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin*”

e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.09.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me Nr. REF-41744-09-14-2022, me objekt: “*Studim projektim për rikonstruksionin e rrugës Adria nga rotonda e Urës së Dajlanit deri tek rotonda pranë Stacionit të Trenit*” me fond limit 2.988.992 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 29.09.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të parakualifikimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), rezulton se, autoriteti kontraktor në datën 06.10.2022, ka njoftuar operatorët ekonomikë kandidatë me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

- | | |
|-------------------|--------------|
| - Facilant SHPK | Kualifikuar |
| - 4 A Studio SHPK | Skualifikuar |

- 47 EK 79 & Iliriada PKS SHPK Skualifikuar
- A.SH. Engineering SHPK Skualifikuar
- CEC Group SHPK Skualifikuar
- DAAM SHPK Kualifikuar
- Ineratech SHPK Kualifikuar
- Institudi Dekliada- Alb SHPK Kualifikuar
- Sphera SHPK Skualifikuar
- Studio Services K-SA Skualifikuar

Operatori ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK është skualifikuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me argumentet e mëposhtme:

Arsyet e skualifikimit:

1. *Nuk permbush piken 2.3.a te Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 1’100’000 lekë”, pasi nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur, konstatohet se ne permbushje te ketij kriteri, operatori ekonomik nuk ka paraqitur sherbime te ngjashme me objektin e prokurimit ne nje vlere minimale prej 1’100’000 leke.*
2. *Nuk permbush piken 2.3.b te Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme në fushën e projektimit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të gjitha entet e tjera përgjegjëse: Kategoria 2.d-Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe; Kategoria 4.i-Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj; Kategoria 5.cUjësjellës-kanalizime urbane – rurale; Kategoria 6.a-Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore; Kategoria 8.a-Rilevime Inxhinierike, d) Bazamente gjeodezike; Kategoria 11.a-Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore”, pasi pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik, konstatohet se nuk ka paraqitur licencë të vlefshme në fushën e projektimit.*

II.3. Në datën 10.10.2022, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2198/2022 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2601 e operatorit ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence”, me Nr. REF-41744-09-14-2022, me objekt: “Studim projektim për rikonstruksionin e rrugës Adria nga rotonda e Urës së Dajlanit deri tek rotonda pranë Stacionit të Trenit” me fond limit 2.988.992 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 2198/2 prot datë 11.10.2022, me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK.

II.6. Në datën 21.10.2022 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2198/4/6 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.3234/6 prot., datë 18.10. 2022, drejtuar KPP-së, për dijëni shoqërisë ankimuese, bashkëngjitur vendimi i Komisionit të Shqyrtimit me nr. 3234/4 prot., datë 18.10.2022 për ankesën e operatorit ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK. Referuar vendimit të KSHA-së rezulton, se ky i fundit e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1.Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK, me argumentat se: *“Nuk permbush piken 2.3.b te Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme në fushën e projektimit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të gjitha entet e tjera përgjegjëse: Kategoria 2.d-Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe; Kategoria 4.i-Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj; Kategoria 5.cUjësjellës-kanalizime urbane – rurale; Kategoria 6.a-Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore; Kategoria 8.a-Rilevime Inxhinierike, d) Bazamente gjeodezike; Kategoria 11.a-Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore”, pasi pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik, konstatohet se nuk ka paraqitur licencë të vlefshme në fushën e projektimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, në shtojcën 11 *“Kërkesat e veçanta për kualifikim”, pika 2.3. Kapaciteti teknik, gërma “b”, autoriteti kontraktor ka parashikuar plotësimin e kriterit si vijon:*

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme në fushën e projektimit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të gjitha entet e tjera përgjegjëse:

Kategoria 2.

d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

Kategoria 4.

i, Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj.

Kategoria 5.

c- Ujësjellës-kanalizime urbane - rurale.

Kategoria 6.

a) Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

Kategoria 8. a) Rilevime Inxhinierike, d) Bazamente gjeodezike.

Kategoria 11. a) Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “STUDIO SERVICES K – SA” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka paraqitur Shtojcën 12 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, në faqen 6 të të cilit ka deklaruar llojin e dokumentit: Licencë N.6798/20, datë 06.05.2022 “Për projektim”.

III.1.3. Në ankesën e paraqitur, ankimuesi pretendon si vijon: *Per sa i perket pike 2.3 b, lidhur me licences e vlefshme ne projektim, OE sqarojme se: Vete AK ne piken 2.3 C Keto kriteret permbushen nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 12 te DST. OE STUDIO SERVICES K-SA SHPK E KA DEKLARUAR NE SHTOJCEN 12 licencen e tij me Nr. 6798/20 date 06.05.2022 si dhe institucionin leshues si dhe adresen e onlain te institucionit ku jane afishuar licencat e subjekteve. Ne keto kushte edhe pse licenca nuk eshte ngarkuar ne kete faze, OE mund ta ngarkoj ne fazen e dyte te objektit te prokurimit.*

III.1.4. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.5. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.7. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në rastin konkret rezulton se autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentat e tenderit që operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme në fushën e projektimit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të gjitha entet e tjera përgjegjëse: *Kategoria 2. d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe. Kategoria 4. i, Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj. Kategoria 5. c- Ujësjellës-kanalizime urbane - rurale. Kategoria 6. a) Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore. Kategoria 8. a) Rilevime Inxhinierike, d) Bazamente gjeodezike. Kategoria 11. a) Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.* Operatori ekonomik

ankimues pretendon se e plotëson kriterin e larpërmendur nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit, në të cilin ka deklaruar se disponon licencën me Nr. 6798/20 date 06.05.2022 si dhe institucionin leshues si dhe adresen e onlain te institucionit ku jane afishuar licencat e subjekteve. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga shoqëria “Studio Services K-SA” SHPK Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, përveç pohimit të bërë nga shoqëria ankimuese në Formularin e Vetëdeklarimit, se disponon licencën me Nr. 6798/20 date 06.05.2022, në ofertën e paraqitur nuk rezulton të jetë dorëzuar asnjë licencë e vlefshme në fushën e projektimit, sikurse është kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit si më sipër cituar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk e plotëson kriterin lidhur me licencën në fushën e projektimit pasi në dokumentat e tenderit nuk është parashikuar plotësimi i tij nëpërmjet vetëdeklarimit. Argumenti i dhënë prej tij se “*Vete AK ne piken 2.3 C (ka përcaktuar se) keto kritere permbushen nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 12 te DST,* nuk përfshin kërkesën e parashikuar në pikën 2.3/b të DT-ve, si më sipër cituar. Pra pika 2.3.c e cituar nga ankimuesi parashikon që kërkesa për personelin të plotësohet nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sic parashikohet në nenin 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar dhe nenin 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, si më sipër cituar, ndërsa pika 2.3.b e kriterëve të vecanta të kualifikimit nuk është parashikuar të plotësohet nëpërmjet vetëdeklarimit, por duke shkarkuar dokumentin origjinal ose kopje të noterizuar të tij, si pjesë e ofertës së subjektit konkurrues. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Pretendimet e shoqërisë ankimuese nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave*

Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK për procedurën e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me Nr. REF-41744-09-14-2022, me objekt: “*Studim projektim për rikonstruksionin e rrugës Adria nga rotonda e Urës së Dajlanit deri tek rotonda pranë Stacionit të Trenit*” me fond limit 2.988.992 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

